



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 553/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohen programet e studimit të BPrAL Kolegji “Fama” për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018:
 - Stomatologji, Dr Dent (program i integruar), 300 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
 - Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik;
 - Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik.
- II. Nuk ri/akreditohet programi i studimit i BPrAL Kolegji “Fama”:
 - Përkujdesje dhe Mirëqenie për Fëmijë, BA, 180 ECTS;
 - Mjekësi Familjare dhe Kujdes Paliativ, MSc, 120 ECTS.
- III. Obligohet BPrAL Kolegji “Fama” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- IV. Obligohet BPrAL Kolegji “Fama” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji “Fama” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim të programeve të studimit: Stomatologji, Dr Dent (program i integruar), 300 ECTS, Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS, Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS, Përkujdesje dhe Mirëqenie për Fëmijë, BA, 180 ECTS, dhe Mjekësi Familjare dhe Kujdes Paliativ, MSc, 120 ECTS, me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Stomatologji,	Dr Dent	300	Xhevdet Aliu, Ferjal Perjuci, dhe Ali Gashi
2	Laborant Dentar	BSc	180	Nexhmije Ajeti, Fatmire Shllaku, dhe Rezarta Berisha
3	Laborant Mjekësor	BSc	180	Gani Shabani, Antigona Dervishaj Ukëhaxhaj, dhe Ali Lahu
4	Përkujdesje dhe Mirëqenie për Fëmijë	BA	180	Zafer Gashi, Arafat Shabani, dhe Ismet Bujupaj
5	Mjekësi Familjare dhe Kujdes Paliativ	MSc	120	Mire Shoshi, Feim Mazreku, dhe Shqiptar Demaçi

AKA ka organizuar vizitë në Kolegjin “Fama” më 25.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekur me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Ulrike Beier, Markus Paulmichl, Milan Pol dhe Adrian Stan.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit “Fama”, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për sa i përket programit të studimit në Përkujdesje dhe Mirëqenie për Fëmijë, BA, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, stafi akademik për këtë program të studimit nuk ka ekspertë të mjaftueshëm për fushën e edukimit apo këtë program të studimit. Sipas ekspertëve tre bartësit e programit të studimit kanë përgatitje në psikologji dhe njëri nga ta në filologji – gjuhë angleze. Për më tepër njëri nga bartësit e programit duket se ka gjithashtu angazhim të rregullt në Universitetin e Evropës Jug Lindore në Shkup. Për sa i përket rregullave të AKA-së, ekspertët kanë deklaruar se këto fakte nuk mund të shërbejnë si garanci e mjaftueshme për programin e studimit.

Për më tepër, pak raste të zhvillimit të stafit akademik kanë ndodhur dhe se ato kanë ndodhur nga ekspertë të huaj. Sipas ekspertëve institucioni nuk ka politika sistematike të zhvillimit të stafit akademik, as për sa i përket zhvillimit të aftësive ligjëruese dhe as zhvillimit të aftësive të hulumtimit.

Për sa i përket programit të studimit në Mjekësi Familjare dhe Kujdes Palliativ, MSc, 120 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Sipas ekspertëve, një program i nivelit master kërkon angazhim serioz për sa i përket punës hulumtuese që studentët duhet të bëjnë për temat e tyre. Andaj sipas ekspertëve çështje shqetësuese përbën zhvillimi i punës kërkimore. Institucioni sipas ekspertëve ka planifikuar që për punë kërkimore të hartojë vetëm pyetësor për temën e diplomës e cila nuk është e mjaftueshme për të arsyetuar një program në nivelin master. Sipas ekspertëve, institucioni duhet të elaborojë një program më konciz i cili është i krahasueshëm me standardet evropiane.

Për sa i përket stafi akademik, ekspertët kanë mësuar se disa lëndëve propozohen të ligjërohen nga staf i cili ka kualifikim tjetër për nga përmbajtja e lëndëve. Sipas ekspertëve, programi mund të akreditohe vetëm nëse institucioni ka staf të mjaftueshëm i cili ka kualifikimin e duhur për lëndët e propozuara dhe ky kriter për momentin nuk është përmbushur. Institucioni sipas ekspertëve duhet të bëjë përpjekje serioze që të caktojë staf të kualifikuar përpara se programi të fillojë implementimin.

Për sa i përket financave dhe infrastrukturës, ekspertët kanë mësuar se ka mangësi për sa i përket buxhetit dhe se ekzistojnë brenga serioze që institucioni ka fonde të pamjaftueshme për të bërë punë hulumtuese të bazuar në klinika. Rrjedhimisht kjo do të dëmtonte seriozisht cilësinë e edukimit si dhe edukimin e vazhdueshëm të stafit akademik.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "Fama";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë